

LIGJ
Nr.8341. datë 6.5.1998

**PËR DISA NDRYSHIME DHE SHTESA NË LIGJIN NR.7504, DATË 30.7.1991 "PËR
POLICINË E RENDIT"**

Në mbështetje të nenit 16 të ligjit nr.7491, datë 29.4.1991 "Për dispozitat kryesore kushtetuese", me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI POPULLOR
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Në ligjin nr.7504, datë 30.7.1991 "Për Policinë e Rendit" bëhen këto ndryshime:

Neni 1

Në fund të nenit 1 të ligjit nr.7504, datë 30.7.1991 "Për Policinë e Rendit" shtohet paragrafi i dytë me formulimin e mëposhtëm:

"Policia e rendit publik përbëhet nga policia e rendit, policia kriminale, policia kufitare, policia speciale dhe ato të ndërhvjes së shpejtë."

Neni 2

Në fund të nenit 2 të ligjit nr.7504, datë 30.7.1991 "Për policinë e rendit", pas fjalës "të objektivitetit" shtohen fjalët "dhe të sekretit profesional."

Neni 3

Në nenin 5 fjalët "sekretin shtetëror" zëvendësohen me tjalët ",sekretin profesional e shtetëror".

Neni 4

Neni 7 ndryshon si vijon:

"Polici, nënoficeri dhe oficeri i policisë të rendit publik, kur janë në detyrë janë të paprekshëm. Fyerja, kanosja, goditja dhe vrasja e tij dënohen sipas Kodit Penal. Ata dhe familja e tyre gëzojnë mbrojtje të veçantë ekonomike dhe financiare.

Neni 5

Në nenin 8, paragrafi 2 ndryshohet si vijon:

Organet e policisë janë Drejtoria e Përgjithshme e Policisë, si dhe drejtoritë e veçanta të policisë në ministri dhe ato mbi bazë prefekturë, të cilat varen prej saj, si organe drejtimi, kontrolli dhe bashkërendimi të veprimtarisë së reparteve e komisariateve që veprojnë sipas rretheve.

Struktura e tyre miratohet nga Këshilli i Ministrave.

Drejtori i Përgjithshëm i Policisë emërohet nga Kryetari i Këshillit të Ministrave me propozim të Ministrit të Rendit Publik.

Neni 6

Neni 10 ndryshohet si vijon:

"Policia e Rendit Publik" është pjesë përbërëse e komisariateve të policisë që varen nga drejtoritë e policisë në prefektura dhe në qendër, si dhe nga organet e pushtetit lokal për detyra të

veçanta të ngarkuara me ligj.

Neni 7

Në nenin 11 fjalët "Drejtoria e Policisë së Rendit" zëvendësohen me fjalët "Drejtoria e Përgjithshme e Policisë".

Neni 8

Pika 11 e nenit 14 ndryshohet si vijon:

"Me urdhër të prokurorit ekzekuton vendimet e gjykatës për dënimet penale dhe merr masa për sigurimin e transportimit të personave të ndaluar e të arrestuar."

Neni 9

Në nenin 16 hiqet fjala "e hetuesive".

Në nenin 22 fjalët "organet e hetuesisë" hiqen dhe zëvendësohen me fjalët "organet e prokurorisë"; fjala "mostra" zëvendësohet me fjalët "prova materiale" dhe në fund të nenit shtohen fjalët "në përputhje me Kodin e Procedurës Penale".

Neni 10

Neni 23 ndryshohet si vijon:

"Punonjësit e policisë bëjnë kontrolle, sekuestre, ndalime e arrestime në flagrancë të shtetasve, në përputhje me rregullat e përcaktuara në Kodin e Procedurës Penale. Me kërkesën e të ndaluarit ose të arrestuarit në flagrancë, njoftohet familja a një person tjetër që përcakton i ndaluarit ose i arrestuari në flagrancë.

Personi që ndalohet ose arrestohet në kundërshtim me ligjin, ka të drejtë të kërkojë shpërblimin e dëmit material nga organi që e ka ndaluar."

Neni 11

Në nenin 34, paragrafi i dytë pas pikës 5 ndryshohet si vijon:

"Gjoha në vend jepet në masën nga 100-500 lekë nga punonjësi i policisë. Kundrvajtësi mund të ankohet brenda 5 ditëve te shefi i komisariatit të policisë prej të cilit varet punonjësi i policisë që ka vënë gjobën. Vendimi i shefit të komisariatit të policisë është i formës së prerë."

Neni 12

Në nenin 37 shtohet një paragraf me këtë përmbajtje:

"Për nevoja pune në sektorë të tjerë të policisë mund të pranohen dhe të titullohen nënoficerë edhe specialistë e teknikë të fushave të ndryshme mbi moshën 40 vjeç.

Neni 13

Neni 46 ndryshohet si vijon:

"Kur punonjësi i policisë vritet ose bëhet i paaftë për punë gjatë kryerjes së detyrës, familja e tij ose ai vetë përfitojnë pension 100 për qindë të pagesës së fundit."

Neni 14

Në neni 52 fjalët "Ndërmarrjet e transportit" zëvendësohen me fjalët "Shoqëritë dhe institucionet publike", kurse fjalët "shërbejnë në transport" zëvendësohen me fjalët "shërben pranë tyre".

Neni 15

Në të gjitha nenet ku janë përdorur fjalët "Degë e Rendit Publik", ndryshohen dhe zëvendësohen me fjalët "drejtoritë e komisiariatet e policisë".

Neni 16

Titulli i ligjit nr.7504, datë 30.7.1991 "Për Policinë e Rendit" ndryshohet në "Për Policinë e Rendit Publik". Në të gjitha nenet e ligjit nr.7504, datë 30.7.1991 "Për Policinë e Rendit" ku janë përdorur fjalët "policia e rendit", ndryshohen dhe bëhen "policia e rendit publik".

Neni 17

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekretin nr.2088, datë 12.5.1998 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Rexhep Meidani